



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.119/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e koalicionit VAKAT, paraqitur kundër subjektit politik Jedinstvena Goranska Partija (JGB), me seli në Dragash, për shkak të nxitjes së urrejtjes, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 30.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e koalicionit VAKAT, me seli në Dragash, me numër Anr.119/2019, e datës 27.09.2019, me të cilën ka kërkuar që të ndërmerren veprimet ligjore kundër subjektit politik Jedinstvena Goranska Partija (JGP), me seli në Dragash, për shkak të nxitjes së urrejtjes gjatë fushatës zgjedhore.

A r s y e t i m

Koalicionit (VAKAT), me seli në Dragash, ka paraqitur ankesë në PZAP, me datë 28.09.2019, me të cilën pretendon se me datë 27.09.2017, është mbajtur një tubim promouës në fshatin Vranishtë, ku kryetari i JGP-së Adem Hoxha ka përdorur fjalimin e urrejtjes dhe deklaratat e tijë fashiste ku thuhet se “në Gore nuk ka vend për dy komunitete dhe se Grupi i Boshnjakëve duhet të zhduket”. Sipas parashtruesit të ankesës kjo deklaratë është përcjellë edhe nga OSBE dhe IKD. Jedinstvena Goranska Partija (JGB), në përgjigje në ankesë të datës 28.09.2019, thekson se nuk ekziston absolutisht asnjë element i fjalimit të urrejtjes në adresimin e tyre me të cilin kanë bërë thirrje në bashkëjetesë në mes të dy komunitete si dhe në bashkimin e komunitetit goran në Kosovë. Pjesa e adresimit ku thuhet se nuk ka vend për dy komunitete ka të bëjë ekskluzivisht me popullin goran, ku është theksuar se ekziston vetëm një komunitet goran (pavarësisht nga komuniteti boshnjak) e jo që nuk ka vend për komunitetin goran dhe boshnjak. Një deklaratë e tillë është dhënë me qëllim që të gjithë goranët të ftohen në bashkim dhe në këtë nuk ka absolutisht kurrfarë thirrje në urrejtje apo në dhunë.

Kryetari i JGP-së, kërkonë falje nëse dikush është ofenduar në çfarëdo baze etnike, për shkak të gabimit të lëshuar pa koncept.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politik JGP, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 33 par 1 pika I të LZP-së b) të LZP-së, për arsye se shkeljet e pretenduara në ankesë nuk ka të bëjë me nxitje të urrejtjes në fushatën zgjedhore, *gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: Përdorimi i gjuhës në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokoj një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.*

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.119/2019 më datën 30.09.2019

Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haxhi



Këshillë Juridik: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa në kuptim të nenit 118 par.4 të LZP-së.